



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

***STATISTIKA PËR VEPRIMTARINË
GJYQËSORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE***

PËR VITIN 2023

KËRKESAT DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2023

Gjatë vitit 2023 Gjykata Kushtetuese ka pasur **452¹ kërkesa**, nga të cilat 367 kërkesa janë paraqitur dhe regjistruar gjatë vitit 2023, si dhe 85 kërkesa janë mbartur nga viti 2022 , nga këto:


- ✚ **39 kërkesa** janë në shqyrtim në seancë plenare;
- ✚ **54 kërkesa** janë regjistruar gjatë muajve nëntor - dhjetor 2023 dhe, brenda afatit ligjor 3-mujor, janë në fazën e shqyrtimit paraprak. Nga këto, 4 kërkesa janë për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe 50 kërkesat e tjera për shqyrtim paraprak në kolegji.
- ✚ **Për 70 kërkesa** është marrë vendim përfundimtar;
- ✚ **Për 283 kërkesa** është marrë vendim moskalimi.

KOHËZGJATJA

- ❖ Gjykata ka respektuar të gjitha afatet procedurale të kërkesave, në përputhje me parashikimet e ligjit organik të Gjykatës, si dhe me Rregulloren për Procedurat Gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.
- ❖ Mesatarja e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatë për vendimet përfundimtare është 8 muaj dhe për vendimet e moskalimit 3 muaj.
- ❖ Aktualisht Gjykata Kushtetuese nuk ka në shqyrtim asnjë çështje të prapambetur.
- ❖ Vlen të theksohet fakti që në Gjykatë nuk është paraqitur asnjë kërkesë, për tejzgjatje të procesit para Gjykatës Kushtetuese.

¹ Numri i kërkesave me numrin e vendimeve dhe të çështjeve që janë në shqyrtim aktualisht në Gjykatë nuk korrespondon, për shkak se 6 kërkesa janë bashkuar me kërkesa me të njëjtin objekt.


STATISTIKA PËR VITIN 2023



❖ Tabelë krahasimore 2021-2023, në lidhje me kërkesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese, si dhe vendimmarrjet e Gjykatës Kushtetuese.

❖ Vendimet e marra nga Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2023,


Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2023 ka dhënë në total **353 vendime**, 70 vendime përfundimtare dhe 283 vendime mosklaimi.



Më poshtë po paraqesim të dhëna statistikore për kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2023, të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si dhe objektit të kërkesës:

➤ Kërkesat e grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- ✚ 4 kërkesë janë paraqitur nga jo më pak se 1/5-a, e deputetëve;
- ✚ 6 kërkesa janë paraqitur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (për kontroll incidental);
- ✚ 2 kërkesë janë paraqitur nga partitë politike;
- ✚ 12 kërkesa janë paraqitur nga organizatat;
- ✚ 343 kërkesa janë paraqitur nga individët.




➤ Kërkesat e grupuara sipas objektit:

- ✚ 1 kërkesë është paraqitur për interpretim të Kushtetutës;
- ✚ 2 kërkesa janë paraqitur për papajtueshmëri të marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën;
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur për shfuqizim vendimi të Kuvendit të Shqipërisë;
- ✚ 29 kërkesa janë paraqitur për papajtueshmëri të ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën;
- ✚ 5 kërkesa janë paraqitur për *shfuqizim vendimesh të Këshillit të Ministrave*;
- ✚ 4 kërkesa janë paraqitur për kundërshtim të akteve të pushtetit publik;
- ✚ 4 kërkesa janë paraqitur për *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me papajtueshmëri të ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën*;
- ✚ 276 kërkesa janë paraqitur për *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm*;

STATISTIKA PËR VITIN 2023

- ✚ 13 kërkesa janë paraqitur për *konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 12 për *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 20 kërkesa janë paraqitur për *intepretim/ korrigjim/ rishikim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*.



VENDIMET E MARRA NGA GJYKATA KUSHTETUESE GJATË TË VITIT 2023


Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, sipas vitit të regjistrimit, sipas dispozitivit të vendimit, si dhe sipas mënyrës së votimit.

➤ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- ✚ 6 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga një grup deputetësh;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (kontroll incidental).
- ✚ 3 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga organizatat;
- ✚ 59 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët;

Vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje


Gjykatën Kushtetuese



➤ Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2023, të grupuara sipas objektit të kërkesës:

- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt *mosmarrëveshje kompetencash dhe vendime të Kuvendit të Shqipërisë*;
- ✚ 6 vendime u përkasin kërkesave me objekt *papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën*.
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt *shfuqizim vendimesh të Këshillit të Ministrave*;
- ✚ 47 vendime u përkasin kërkesave me objekt *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuadër të procesit të rregull ligjor*.
- ✚ 4 vendime u përkasin kërkesave me objekt *shfuqizimin e vendimeve gjyqësore së bashku me papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën*.
- ✚ 7 vendime u përkasin kërkesave me objekt *konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm*.
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt *saktësim/interpretim/rishikim/ vendime të Gjykatës Kushtetuese*.


Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2023 të grupuara sipas objektit



➤ Vendimet përfundimtare të marra gjatë 2023 të grupuara sipas dispozitivit të vendimit:

- ✚ Për 39 vendime Gjykata ka vendosur *pranimin e kërkesës/pranimin e pjeshëm*;
- ✚ Për 28 vendime Gjykata ka vendosur *rrëzimin e kërkesës*;
- ✚ Për 3 vendime Gjykata ka vendosur *pushim gjykimi/ saktësim vendimi*;


Vendimet përfundimtare të vitit 2023 të grupuara sipas dispozitivit



Vendimet përfundimtare të marra gjatë 2023 të grupuara sipas mënyrës së votimit:

- ✚ 30 vendime janë marrë *njësëri*;
- ✚ 40 vendime janë marrë me *shumicë votash*.

Vendimet përfundimtare të vitit 2023 grupuara sipas mënyrës së votimit



Gjatë vitit 2023 nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese janë marrë 283 vendime moskalimi.

Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, objektit të kërkesës, si dhe Kolegjeve/Mbledhjes së Gjyqtarëve.

➤ Vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga një grup deputetësh.
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (për kontroll incidental).
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga partitë politike.
- ✚ 9 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga organizatat.
- ✚ 268 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët.




➤ Vendime moskalimi të grupuara sipas objektit të kërkesës:

- ✚ 1 vendim i përket kërkesës me objekt interpretimin e Kushtetutës.
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës me objekt papajtueshmërinë e *Marrëveshjes Ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit*.
- ✚ 17 vendime u përkasin kërkesave me objekt *papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën*.
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës me objekt *shfuqizim vendimi të Këshillit të Ministrave*.
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës me objekt *shfuqizim vendimi të Këshillit të Ministrave*, së bashku me vendim të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm.

STATISTIKA PËR VITIN 2023


- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt shfuqizim vendimeve gjyqësore, së bashku me papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën.
- ✚ 216 vendime u përkasin kërkesave me objekt kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuadër të procesit të rregull ligjor.
- ✚ 23 vendime u përkasin kërkesave me objekt konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm
- ✚ 13 vendime u përkasin kërkesave me objekt saktësim/interpretim/rishikim/kundërshtim vendime të Gjykatës Kushtetuese.
- ✚ 8 vendime u përkasin kërkesave me objekt akte të pushtetit publik.



➤ Vendime moskalimi të marra nga Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve:

- ✚ 245 vendime janë marrë nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 38 janë marrë nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Vendime moskalimi të mara nga Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve



STATISTIKA PËR VITIN 2023

Aktualisht (datë 04.01.2024) numri total i kërkesave që presin të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese është **93**, nga të cilat:

- + 39 kërkesa janë në shqyrtim në seancë plenare;
- + 4 kërkesë janë në shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
- + 50 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;

Janar 2024